

**STATUT/AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"COASTAL ESCAPE"**

Ne baze te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME
FORMIMI I SHOQERISE
NENI 1**

1. Shoqeria tregtare "COASTAL ESCAPE" shpk me seli ne adresen Njesia Tirane Vangjel Noti, ish-Kombinati "Josif Pashko" Tirane, formohet nga ortakët themelues:

BON TON CONSULTING S.r.l., me seli ligjore ne Viale Luigi Schiavonetti, n. 270, 00173 Rome (me kod fiskal dhe NIPT 14397961005) perfaqesuar ne kete akt nga Dott. Alessandro Bon ne cilesine e perfaqesuesit ligjor i cili perfaqesohet nga i deleguari Z. Pietro Di Pierri i datelindjes 20/12/1969, lindur ne Rome, madhor me zotesi te plote juridike.

ALBAN COSTRUZIONI shpk me seli ne Rruga Vangjel Noti Laprake Tirana, nipt J61904069R perfaqesuar ne kete akt nga Dott. Claudio Michelacci ne cilesine e perfaqesuesit ligjor.

Te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe ne perputhje me ligjin "PER SHOQERITE TREGTARE", REGJISTRIN TREGTAR si dhe AKTIN E THEMELIMIT ka vendosur te destinoje ne kete sipermarrje kapitalin e tij vendas, me qellim qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private e shoqerise, si dhe te perballojne humbjet deri ne kufirin e e vleres se kontributit ne kapitalin themeltar.

2. Shoqeria e ushtron veprimtarine ne baze te ekonomise se tregut te lire.

3. Shoqeria eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar duke u pajisur me lejen e ushtrimit te te profesionit nga zyra e qendres kombetare te regjistrimit (QKB) te rajonit perkates.

4. Shoqeria tregtare "COASTAL ESCAPE" shpk fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit te saj prane zyres se qendres kombetare te regjistrimit (QKR).

**FORMA, EMERTIMI
NENI 2**

1. Shoqeria Tregtare eshte e organizuar si Shoqeri Tregtare me pergjegjesi te kufizuar.


2. Emertimi i Shoqerise eshte "COASTAL ESCAPE" shpk.

3. Ne rast transferimi te veprimtarise tregtare mund te ruhet i njejti emertim, me kusht qe personi juridik te shtojë ne kete emertim nje shenim i cili ka te beje me transferimin.

4. Shoqeria zoteron dhe perdor marken, simbolin dhe vulen e saj me emrin "COASTAL ESCAPE" ose "COASTAL ESCAPE" ose "COASTAL ESCAPE". Keto nuk mund te zoterohen apo perdoren nga pale te tjera si vendas apo te huaj pa miratimin me shkrim te asamblese se ortakëve te kesaj shoqerie.

**SELIA
NENI 3**

Selia e shoqerise "COASTAL ESCAPE" shpk ndodhet ne Tirane Vangjel Noti, ish-Kombinati "Josif Pashko" Tirane Albania. Shoqeria mund te krijojë filiale, degë e perfaqesi ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise ashtu dhe jashte territorit te saj sipas nevojave. Selia mund te ndryshohet/transferohet ne cdo vend tjeter me vendim te



Asamblese se Ortakut/eve, i cili ratifikohet nga mbledhja e afert e asamblese se zakonshme. Keto vendime depozitohen ne Regjistrin Tregtar.

NENI 4

KOHEZGJATJA


1. Shoqeria tregtare "COASTAL ESCAPE" shpk do te ushtroje aktivitetin e saj per nje afat te pacaktuar.
2. Ndryshimet duke perfshire edhe edhe percaktime te mevonshme ne lidhje me kohezgjatjen e aktivitetit te saj nuk sjellin si pasoje krijimin e nje personaliteti juridik te ri.

OBJEKTI

NENI 5

Shoqeria "COASTAL ESCAPE" sh.p.k., ka si objekt veprimtarie:

- Te marre (pervetesoje) dhe/ose negocioje toka, te kerkoje dhe marre pjesë në tenderë për koncesionet e qeverisë;
- Përgatitja e projekteve paraprake duke shfrytëzuar/vlerësuar know how e shoqërisë A;
- Përgatitja e planeve te investimit, analizave te tregut dhe vlerësimein e tokave te pervetesuara (marra) dhe/ose atyre ne koncension;
- Te zhvilloje analiza tregu, prezantime, plane financiare për zhvillim te finalizuara me optimizimin e rendimetit financiar të investimeve të propozuara;
- Identifikimi i partnereve menaxhues të strukturave hoteliere turistike.
- Te financojë nëpërmjet kapitalit të palëve të treta zhvillimin imobiliar ne objektiv;
- Ndërtimi i infrastrukturës në tërësinë e tyre;
- Mobilimin "turn key" te strukturave hoteliere dhe atyre rezidenciale;
- Vënien në funksion të strukturave te hotelerise turistike permess shoqerive primare te menazhimit hotelier;
- Pozicionimin e tregut të strukturave dhe aktivitetet përkatëse të marketingut gjatë fazës së ndërtimit;
- Mirëmbajtjen imobiliaare te strukturave turistike dhe rezidenciale;
- Në përgjithësi, të kryejë të gjitha aktivitetet e nevojshme dhe të lidhura me aktivitetet e përmendura ne pikat messiperme;
- Perthithje kontratash sipermarrje apo nen sipermarrje te zhvillimeve te ndryshme ndertimore apo menaxheriale nga pale te treta te pa perfshira ne kete konrate JV.
- Shoqeria mund te kryeje cdo veprim apo operacion tjeter komercial, industrial e financiar, te dobishem apo plotesues ndaj permbushjes se objektit te Shoqerise, me kusht qe aktivitetet e mesiperme te mos jene ne kundershtrim dhe te mos alterojne objektin paresor te Shoqerise;
- Projektimi, ndertimi dhe shitja e pasurive te paluajtshme me destinacion rezidencial dhe perdorim hotelier/komercial, duke perfshire administrimin e tyre, si dhe ofrimi i sherbimeve te hoteleri-turizmit, si dhe cdo veprimtari tjeter plotesuese, qe lidhet direkt ose indirekt me vepimtarite e siperpermendur. Shoqeria mund te bashkepunoje dhe/ose bleje/perfitoje direkt ose indirekt pjesemarrje, ne shoqeri, ndermarrje, agjenci apo sipermarrje te tjera, te cilat kane fushe veprimtarie te ngjashme.



NENI 6

Shoqeria Tregtare "COASTAL ESCAPE" sh.p.k., nuk përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria ekonomike-tregtare që ortaket zhvillojnë në mënyrë të pavarur prej saj.

Ky kapital depozitohet sipas ligjit. Në librin e llogarise të Shoqerise krijohet fondi themeltar ku shënohet kapitali i ortakeve.

NENI 7

KAPITALI

Kapitali fillestar aksionar është në vlerën 50 000.00 EURO, i përbërë ekskluzivisht nga kontributet në para të ortakeve, të ndara si më poshtë:

- BTC 25.000,00 EURO
- ALBAN COSTRUZIONI 25.000,00 EURO
- Kapitali aksionar i paguar nga palët në momentin e regjistrimit në Regjistrin e Shoqërive do të jetë në vlerën 10.000,00 euro të paguara si më poshtë:
 - SHOQERIA A 5.000,00
 - SHOQERIA B 5.000,00
- Palët do të paguajnë më tej brenda një viti nga data e regjistrimit në Regjistrin e shoqërive shumën e mbetur, pra 40.000,00 të ndarë si më poshtë:
 - o SHOQERIA A 20.000,00
 - o SHOQERIA B 20.000,00
- Rritjet e kapitalit vendosen nga Asambleja e Ortakeve, me votën e favorshme të një mazhiorance të ortakeve që përfaqësojnë të paktën 80% të kapitalit aksionar, pas propozimit paraprak të Keshillit të Administrimit me votën e favorshme të katër anëtarëve.

NENI 8

Shoqeria ka të drejtë të krijojë fondin rezerve dhe fonde të tjera të vecanta të financimit për zhvillimin ekonomik dhe tregtar.

NENI 9

1. Përbeja e kapitalit të shoqerise, fondet e krijimit të saj si dhe përdorimi dhe rregullimi i cdo fondi të vecante përcaktohen nga ortaket sipas të drejtave dhe detyrave të përcaktuara në statut.
2. Te ardhurat e përgjithshme të shoqerise dhe në përgjithësi cdo operacion financiar i saj do të pasqyrohet në kontabilitetin e shoqerise sipas legjislacionit në fuqi dhe në mbështetje të akteve perkatese të rrjedhura prej tij.

NENI 10

1. Shoqeria tregtare "COASTAL ESCAPE" sh.p.k., është pronare e pasurise se saj të cilën e përdor dhe e disponon në emër të saj në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.
2. Shoqeria është e lirë të marrë, të perdore, të blejë apo shesë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale në përputhje me legjislacionin perkates.
3. Të gjitha shpenzimet për ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistencë teknike, apo kontabiliteti dhe juridike paguhen vetëm nga fondet e shoqerise.

NENI 11

1. Pasunte e shoqerise vleresohen ne monedhe shqiptare.
2. Aktiviteti financiar i shoqerise do te mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti dhe bilanci do te miratohet brenda tre muajve te vitit ne vazhdim.
3. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta te ortakeve te hartuara nga ortaket dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen me vendim te ortakeve.

NENI 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.

NENI 13

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfutues do te behet pasi ata te pranojne permbajtjen e statutit te kesaj shoqerie tregtare me gjithë ndryshimet qe ai mund te kete pesuar deri ne momentin qe keto pjese te kapitalit themeltar behen te transferueshme.

NENI 14

Ne rast mospranimit, pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin e ortakeve.

NENI 15

Zmadhimi i kapitalit themeltar me ane te kontributeve ne para dhe ne natyre apo zvogelimi i tij behet me vendimin e ortakeve mbi bazen e nje projekti te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar.

NENI 16

ORTAKERIA

Ortaket e shoqerise tregtare "COASTAL ESCAPE" sh.p.k., gezojne te gjitha te drejtat dhe marrin persiper te gjitha detyrimet qe pasqyrohen ne legjislacion e republikes se shqiperise, ne aktin e themelimit dhe ne satutin e shoqerise.

NENI 17


TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE.

1. Te marrin pjese ne mbledhjet e asamblese se ortakeve duke ushtruar te drejten e votes.
2. Te paraqesin pyetje me shkrim ne lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqerise ndaj administratorit.
3. Te informohen mbi pergatitjen e raportit te administrimit, inventaret e llogarite vjetore, tekstet e vendimeve te propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabel.
4. Te perfitojne nga fitimi i shoqerise.
5. Te kerkojne prishjen e shoqerise ne rrethana te caktuara.

NENI 18

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

1. Shoqeria do te administrohet nga dy Administrator te zgjedhur nga Ortaket e Shoqerise. Si Administrator te shoqerise do te zgjidhen **Claudio Michelacci** nr id personal **G04120001K** dhe **Adis Halili**, me nr id personal **I80302070P**, me nje afat 5



- vjetar, e cila përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet. Administratori do të kryejë të gjitha veprimet zyrtare të shoqërisë
2. Shoqëria, në të ardhmen mund të administrohet edhe nga një Administrator tjetër, i cili emërohet me Vendim të Ortakut/eve.
 3. Administratori, mund t'i delegojë kompetencat e tij (pjesërisht ose të gjitha) me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
 4. Vendimet e ortakëve, evidencohen në një regjister të veçantë.

NENI 19

ASAMBLEJA

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë:

1. Të hartojë e miratojë ndryshimet në statut.
2. Të miratojë bilancin vjetor të shoqërisë.
3. Të vendosë për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit.
4. Të emërojë dhe shkarkojë administratorin e shoqërisë.
5. Të shpallë prishjen, likuidimin dhe falimentimin e shoqërisë.

Procesverbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.

NENI 20

TE DREJTAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka këto të drejta:

1. Të mbikëqyrë dhe të kontrollojë gjithë veprimtarinë e shoqërisë.
2. Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet, në administratën publike dhe organelet gjyqësore.
3. Të emërojë personelin e domosdoshëm.
4. Të administrojë pasurinë dhe mjetet financiare të shoqërisë.
5. Të therrase asamblet dhe të vendosë rendin e ditës.
6. Të hartojë planet e llogarive ekonomike dhe të paraqesë ato për miratim asamblese së ortakëve.

7. Administratori/et përfaqëson/jnë ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr. 9901, datë 14 Prill 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme. Për më shumë qartësi, Administratori/et përveç kompetencave të parashikuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare përmes këtij Statuti, ka të drejtë të: të kryejë blerjet, shitjet, nënshkrimin e kontratave me palë të treta për mallra, punë, shërbime apo çdo lloj marrëdhënie tjetër e cila nuk është nën përgjegjësinë direkte të Asamblesë së Përgjithshme deri në vlerën e barabartë me 10.000,00 EUR (dhjetë mijë Euro), për çdo transaksion. Mbi këtë vlerë dhe deri në 2.000.000,00 EUR (dy milion Euro), aprovinë i transaksionit i takon Asamblese së Përgjithshme;

8. Asambleja e përgjithshme autorizon me vendim fuqitë e administratorit në lidhje me shitjet, hartimin e kontratave të qerese, lenien e hipotekave apo garancive, në lidhje me njesitë e banimit dhe/ose shërbimeve turistike komerciale të çilesdo natyre si me klientet e interesuar, në të cilat Shoqëria rezulton investitore ose përfutuese toke, pa ju nënshtruar kufizimeve të specifikuar në piken a, me siper: të hartojë, formalizojë dhe komunikojë procedurat e brendshme, urdherat dhe indikacionet që rezultojnë nga ky statut dhe/ose nga rregullat e brendshme të aprovuara nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

9. të miratojë dhe firmosë marrëveshje sipas së cilave miratohet vendosja e barrëve sigurtuese mbi të drejtat ose barrë hipotekore mbi pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të Shoqërisë apo ende në proces zhvillimi nga Shoqëria, në favor të bankave të nivelit të dytë, për të

garantuar pagesën e detyrimeve monetare nga ana e klientëve që kanë blerë nga shoqëria, këto pasuri të paluajtshme nëpërmjet financimit nga bankat e nivelit të dytë.

10. Për të shmangur çdo paqartësi dhe ambiguitet në lidhje me kompetencat e Administratorit në raport me institucionet bankare në Republikën e Shqipërisë dhe pa përgjashtuar sa më sipër përcaktuar në këtë Statut, cilësohet specifikisht se Administratori mund: a. të veprojë i vetëm në emër e për llogari të Shoqërisë, lidhur me kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme me qëllim hapjen/mbylljen e llogarive bankare të Shoqërisë pranë bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, si dhe aktivizimin ose çaktivizimin nga ana e Shoqërisë e të gjitha shërbimeve specifike të ofruara nga banka/at lidhur me llogaritë bankare të hapura prej tij;

11. të autorizojë i vetëm caktimin/heqjen e personave që kanë të drejta të përdorin dhe të kryejnë veprime nëpërmjet sistemeve të 'online banking' pranë bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë;

12. të kryejë çfarëdolloj veprimi tjetër që lidhet me administrimin e zakonshëm të përditshëm të Shoqërisë pranë çdo banke të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, që nuk bie ndesh apo kufizohet me vendime të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë apo procedura të tjera të caktuara në këtë Statut apo në ligj.

13. të kryejë veprimet e nevojshme në institucionet bankare përkatëse për pajisjen me kartë/ta krediti biznesi për nevojat e përditshme të Shoqërisë. Administrator/ët mund të vendosi/in që më shumë se një person nga Shoqëria të pajiset me kartë krediti biznesi. Në çdo rast, limiti i kreditimit në agregat do të jetë i kufizuar në vlerën maksimale prej 4.000,00 Euro (kater mijë Euro).

14. Administratori/ët mund të emërojë/në përfaqësues me prokurë speciale ("ad negotia") për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre nga ligji në fuqi ose ky Statut.

15. Përsa i përket ndarjes së kompetencave me qëllim perdipoziten e një projekti dhe plani financiar do të delegohet një Asamble e Posacme e Ortakëve, brenda dhe jo me pas dates 31.03.2025.

NENI 21

Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vete shoqërise ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për faj të kryera gjatë administrimit të shoqërise.

NENI 22

1. Shoqëria "COASTAL ESCAPE" sh.p.k., mund të emërojë në vazhdimësi një ekspert kontabel për një afat kohor të përcaktuar me të drejtë rizgjedhje.
2. Emerimi kryhet nga ortakët.
3. Për kompetencat, shkarkimin dhe shpërblimin etij zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

NENI 23

MARREDHENIET E PUNESIMIT

1. Të gjithë personat që do të punesohen pranë kësaj shoqërie, punesimi i tyre do të bëhet në bazë të kontratës individuale të punës ose kolektive, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të seciles pale si dhe paga mujore në përputhje me legjislacionin vendas në këtë fushë.
2. Marrja në punë bëhet me anë të regjistrimit nga ana e punëdhënesit në librin e punës së shoqërise.
3. Largimi nga vendi i punës bëhet në bazë të një akti me shkrim të leshuar nga

administratori. Largimi nga puna lidhet me mbarimin e kontrates se punes, per shkak te shkeljes disiplinore ose me kerkesen e te interesuarit.

4. Mos marreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise do te zgjidhen me mirekuptim, ose kur ky i fundit nuk eshte i mundur palet do ti drejtohen gjykates kompetente perkatese.

NENI 24

BASHKIMI DHE NDARJA E SHOQERISE

1. Shoqeria tregtare "COASTAL ESCAPE" sh.p.k., me ane te bashkimit mund ti kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ato themelojne dhe qe ushtron te njejtin aktivitet.

2. Shoqeria tregtare "COASTAL ESCAPE" sh.p.k., me ane te ndarjes mund ti kaloje trashegimine e saj disa shoqerive te tjera ezistuese ose shoqerive te reja.

NENI 25

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE.

1. Shoqeria mund te priset ne cdo kohe dhe per cfare do lloj shkakut, si ne rast falimentimi, privimi te te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga ortaket.

2. Shoqeria hyn ne fazen e e likujdimit qysh ne momentin e prishjes se saj.

Per kete, ortaket emerojne nje ose me shume likujdator.

3. Shoqeria priset ne keto raste:

- Kur nuk mund te permbushet objekti per te cilin eshte krijuar.
- me vullnetin e ortakeve.
- me vendim te gjykates.
- kur mbaron afati i veprimtarise se shoqerise.

NENI 26

DISPOZITA TE FUNDIT

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut do te aplikohet ligji "PER SHOQERITE TREGTARE" si dhe legjislacioni ne fuqi.

NENI 27

Ky statut hyn ne fuqi ditën e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin treglame qendren kombetare te regjistrimit (QKB).

NENI 28

Ky statut perpihet ne 3 kopje origjinale me te njejten vlere ligjore perktheu Greta Jaupaj njohur dhe pranuar nga ortaket.

Njeri prej tyre ruhet ne dokumentacionin e shoqerise.

ORTAKET E SHOQERISE

Alessandro BON

Perfaqesuar nga

Pietro di Perri

Claudio Michelacci

Perkthyes Greta Jaupaj